



Data: 19 Nëntor 2020

Për: Avdullah Hoti, Kryeministër i Republikës së Kosovës  
Skender Reçica, Ministër i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale  
Hykmete Bajrami, Ministre e Ministrisë së Financave

Nga: Donjetë Kelmendi, Drejtor Ekzekutiv në Koalicionin e OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF

Lënda: Letër e hapur - Shërbimet sociale rrezikojnë të ndërpriten në Janar 2021

Të nderuar,

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF, i cili përfaqëson tridhjetë e një organizata jo qeveritare, në kuadër të misionit për avokim në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, kërkon ndërmarrjen e masave të menjëhershme për parandalimin e mbylljes së shërbimeve për fëmijët e cënueshëm sikurse të atyre pa kujdes prindëror, viktimat të abuzimit dhe dhunës në familje si dhe zgjidhjen afatgjate të financimit të shërbimeve sociale.

Situata e krijuar me COVID-19 sikurse në gjithë botën edhe në Kosovë ka rënduar në masë të madhe grupet e cënueshme dhe kjo ka ndikuar në rritjen e numrit të rasteve të dhunës në familje. Pandemia ka ndikuar edhe në shumë sfera tjera dhe ka rënduar gjendjen socio-ekonomike të qytetarëve të Kosovës ku si pasojë është rritur edhe numri i fëmijëve pa përkujdesje prindërore.

Shumë shërbime të ofruara nga institucionet e Republikës së Kosovës dhe organizatat jo qeveritare për grupet e cënueshme kanë qenë të kufizuara gjatë kësaj periudhe si pasojë e vendosjes së masave për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, ku shumë fëmijë të cënueshëm kanë mbetur pa shërbime.

Strehimoret<sup>1</sup> e licencuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për ofrimin e shërbimeve rezidenciale po vazhdojnë të përballen me paqëndrueshmëri financiare. Shërbimet rezidenciale për fëmijët pa përkujdesje prindërore, fëmijët viktimat të abuzimit dhe keqtrajtit, fëmijët viktimat të dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit (niveli i ulët i rrezikut) financohen nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përmes thirrjeve publike çdo vit dhe që nga viti 2016 ka zbrazëtira kohore mes thirrjeve/kontratave për mbështetje duke lënë pa përkrahje financiare këto strehimore çdo fillim vit.

Situatë e njëjtë është edhe tani ku këto strehimore posedojnë financimin vetëm deri në 31 Dhjetor 2020. Si pasojë e mungesës së financimit strehimoret rrezikojnë të mbyllën përkohësisht nga 1 Janari i vitit 2021. Ndërprerja e ofrimit të këtyre shërbimeve, qoftë edhe përkohësisht do të lërë pa strehë fëmijët e akomoduar aktualisht në këto strehimore dhe po ashtu do të mbyllë derën për rastet e reja që mund të jenë në nevojë për shërbime rezidenciale, duke shkelur kështu të drejtën themelore të fëmijëve për mbrojtje.

Me një situatë të rëndë po përballen edhe ofruesit e shërbimeve për fëmijët e tjerë të cënueshëm si fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët në strehim familjar apo fëmijët e përfshirë në punë të rënda.

---

<sup>1</sup>Strehimoret e licencuara janë në kuadër të sektorit jo qeveritar të cilat janë të kontraktuara nga MPMS për ofrimin e shërbimeve rezidenciale

Organizatata ofruese të shërbimeve përmes qendrave ditore dhe shërbimeve në familje e komunitet, nuk kanë marrë asnjë mbështetje financiare përgjatë vitit 2020, nga MPMS.

Kërkojmë konsideratën tuaj që në emër të përgjegjësive kushtetuese për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë, si Kryeministër dhe ministra të Republikës së Kosovës, të merrni veprimet të cilave ua kemi bashkangjitur faktet më poshtë.

- Ndërmarrjen e masave të menjëhershme për parandalimin e mbylljes së përkohshme të shërbimeve në kuadër të strehimoreve për fëmijët pa përkujdesje prindërore, viktimat të dhunës dhe abuzimit, viktimat të trafikimit (niveli i ulët i rrezikut) në Janar 2021, përmes shpalljes së parë të thirrjes nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për mbështetjen e shërbimeve sociale direkte të ofruara nga strehimoret e licencuara.
- Ndërmarrjen e masave të menjëhershme për të rregulluar mekanizmin e financimit të qëndrueshëm për të gjitha shërbimet sociale për fëmijët e tjerë të cenueshëm, si fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët në strehim familjar apo fëmijët e përfshirë në punë të rënda, duke nxjerrë thirrje të rregullta të cilat nuk do të lënë zbrazëti apo boshllëqe kohore të pambuluara financiarisht, gjë e cila ndodh çdo vit dhe rezultojnë me ndërprerje të shërbimeve sociale.
- Krahas ofrimit të ndihmës së menjëhershme për parandalimin e mbylljes së shërbimeve në kuadër të strehimoreve, të procedoni sa më shpejt procesin e miratimit të Projekt Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, (i cili është në proces hartimi), e i cili parashihet krijimin e Grantit Specifik për Shërbime Sociale, me qëllim zgjidhjen afatgjate të problemit të financimit të shërbimeve sociale.

Fakte:

1. Pandemia Covid-19 ka rënduar në përgjithësi gjendjen e fëmijëve të cenueshëm. Periudha e zgjatur e izolimit, kushtet e rënda të jetesës dhe vështirësitë financiare kanë ndikuar në rritjen e përdorimit të dhunës ndaj fëmijëve dhe në përgjithësi rritjen e dhunës në familje. Përveç kësaj, gjendja e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe e prindërve të tyre është rënduar edhe më shumë gjatë pandemisë. Fëmijët me aftësi të kufizuara kanë mbetur pa shërbimet esenciale sociale dhe rehabilituese, si edhe pa mbështetjen e nevojshme psikologjike. Kriza dhe masat e izolimit kanë ndikuar në përkeqësimin e shëndetit mendor, prandaj mbështetja profesionale ndaj fëmijëve dhe prindërve të tyre është e rëndësishme dhe e domosdoshme. Fëmijët e përfshirë në punë të rënda, edhe gjatë pandemisë po vazhdojnë të jenë në rrezik për jetën, shëndetin dhe po ekspozohen ndaj abuzimit, shfrytëzimit seksual dhe trafikimit.
2. Bazuar në të gjeturat e Raportit të Monitorimit të Shërbimeve Sociale<sup>2</sup> të publikuar nga KOMF në Qershor 2020, shërbimet sociale janë në gjendje shumë të rëndë dhe po përballen me mungesë të financimit të qëndrueshëm. Aktualisht, ende nuk është bërë kostimi i shërbimeve sociale, nuk është hartuar formula e financimit dhe nuk është krijuar plani për financim të qëndrueshëm të shërbimeve sociale. Prandaj është e domosdoshme të ndërmerren masat në sigurimin e një zgjidhjeje të qëndrueshme të financimit të shërbimeve sociale, konkretisht aplikimin e Grantit Specifik për Shërbime Sociale<sup>3</sup> përmes procedimit dhe miratimit të Projekt Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal.
3. Në vitin 2019, buxheti total i MPMS ishte 466.7 milionë Euro, ku pjesa dërrmuese është ndarë për skema dhe transfere, përkatësisht 453.2 milionë Euro apo 97,7% e buxhetit të kësaj ministrie. Në total, për shërbime sociale MPMS ka ndarë vetëm 3 milionë Euro, apo përkthyer në përqindje, 1 përqind të buxhetit të saj. MPMS përmes procesit të thirrjes së rregullt publike, ka ndarë 900,000 Euro për financimin e shërbimeve sociale direkte të ofruara nga sektori jo-qeveritar. Megjithatë, kjo mbështetje mbulon vetëm një pjesë të kostos së shërbimeve si dhe ajo pritet të përfundojë në Dhjetor 2020. Gjatë muajve Janar – Mars 2021 (bazuar në praktikën e pesë viteve të mëparshme) pritet të ketë zbrazëti kohore mes thirrjeve nga MPMS, gjë që do pasojë me mbylljen e përkohshme të shërbimeve të ofruara nga strehimoret e licencuara për fëmijët në nevojë për mbrojtje.
4. Përkundër decentralizimit të shërbimeve sociale, të iniciuar nga 1 Janari 2009, komunat në përgjithësi nuk ndajnë buxhet për ofrimin e shërbimeve sociale të bazuar në nevojat e qytetarëve brenda komunave. Komunat nuk kanë krijuar një skemë të qëndrueshme të kontraktimit për blerjen e shërbimeve sociale nga sektori jo-qeveritar. Mbështetja e komunave

<sup>2</sup>Raporti i Monitorimit "Komuna ime, e drejta ime sociale", KOMF, Qershor 2020 <http://www.komfosova.org/ep-content/uploads/2020/06/Raporti-i-Monitorimit-ALB.pdf>

<sup>3</sup>Qëndrimi për Grantin Specifik për Shërbime Sociale, KOMF, Nëntor 2020

mbetet ad hoc dhe varion nga komuna në komunë. Mungesa e një granti specifik për komunat për shërbimet sociale, i pamundëson këto institucione në përmbushjen e mandatit dhe obligimeve të parapara me legjislacionin në fuqi. Nëse vazhdohet me këtë formë të financimit gjendja mund të keqësohet për aq sa ta sjellë QPS-të dhe OJQ-të në qendra jofunksionale, të cilat duke mos u financuar mjaftueshëm nuk do të mund të ofrojnë shërbime sociale.

*Baza ligjore për obligimin e shtetit për mbrojtjen e fëmijëve dhe qytetarëve në nevojë:*

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe legjislacioni në fuqi garanton të drejtën e fëmijëve për mbrojtje. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në Nenin 50, ka paraparë të drejtat e fëmijës, ndër të tjera edhe atë se fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre si dhe të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës në Shtator të këtij viti ka miratuar një amandament në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në bazë të të cilit Konventa e Stambollit do të përfshihet në këtë Kushtetutë. Kjo Konventë njihet në botë si instrument ligjor për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe të dhunës në familje, si dhe për mbrojtjen e viktimave, dhe ky fakt rrite dhe më shumë përgjegjësinë e institucioneve për të ju përgjigjur obligimeve që kanë në fushën e parandalimit dhe mbrojtjes së viktimave të dhunës.
- Ligji për Familjen i Kosovës Nr. 2004/32, Neni 5 definon që fëmijët pa përkujdes prindëror dhe fëmijët me aftësi të kufizuara, si dhe prindërit të cilët nuk janë të aftë të krijojnë kushtet e domosdoshme jetësore për vete dhe për fëmijët e tyre, janë nën përkrahjen e veçantë financiare dhe shoqërore.
- Ligji Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, përcakton që në rrethanat kur nuk ka përkrahje nga familja ose kur ajo nuk është e mjaftueshme për të siguruar mirëqenien e një individi, shteti ka për detyrë të ofrojë shërbime sociale dhe familjare.
- Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Kreu III, Neni 17 përcakton që komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, siç është përkujdesi për të cenueshmit, strehimin familjar.

KOMF bën me dije, në qoftë se nuk do ndërmerren masat e menjëhershme për parandalimin e mbylljes së shërbimeve rezidenciale për fëmijët viktime, në nevojë nevojë për strehim do të cenohen rëndë të drejtat dhe mirëqenia e fëmijëve në Kosovë.

KOMF ka parasysh që gjendja e përgjithshme ekonomike është rënduar si pasojë e pandemisë Covid-19, por mbrojtja e të drejtave themelore të fëmijëve duhet të jetë prioritet absolut për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke e vendosur këtë prioritet para investimeve kapitale.

Sinqerisht,

Donjetë Kelmendi

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF

Organizatat anëtare të KOMF janë: Asociacioni për Trajnime Sociale, Hulumtime dhe Avokim – ASTRA, Aksioni për Nëna dhe Fëmijë, Balkan Sunflowers Kosova, Childproof/CIPOF, Education Comes First – ECF, Iniciativa 6, Organizata Rinore Akti – Ora, Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror – OFAP, OPFAKKOS, Programi për të Drejtat Civile – CRP/K, PL4Y International, Qendra për Arsim e Kosovës – KEC, Qendra e Kujdesit Ditor PEMA, Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të qenieve njerëzore – MVPT, Qendra për Studime të Avancuara – FIT, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – QKRMT, Save the Children, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, Shpresa dhe Shtëpi e Fëmijëve Kosovë SDSF, Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë – PRAK Kosova, Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës – HANDIKOS, Terre des hommes, The Ideas Partnership, VoRAE, World Vision, Public Organization for Local Initiatives and Supports – POLIS, Network of Peace Movement – NOPM, Qendra Sociale – Edukative SOS Kopshti, Nevo Koncepti, Qendra “Labyrinth” dhe Organizata Jo-Qeveritare Peer Education Network – PEN.